

V E N D I M
Nr.558, datë 1.8.2003

**PËR SHPALLJEN E VOSKOPOJËS "QENDËR HISTORIKE" DHE VËNIEN E SAJ NË
MBROJTJE TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 pika 23 dhe 31 pika 1 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen e Voskopojës "Qendër historike" dhe vënien e saj në mbrojtje të shtetit, sipas hartës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, të hartojnë rregulloren e administrimit dhe të menaxhimit të kësaj zone, në përputhje me masterplanin e miratuar nga KRRTRSH-ja, si zonë me përparësi për zhvillimin e turizmit, si dhe projektet për mbrojtjen, ruajtjen dhe restaurimin e elementeve përbërëse të kësaj qendre historike.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

